

KËSHILLI DREJTUES

**VENDIM QARKULLUES**

**Nr. 39, datë 15.12.2020**


**Mbi përzgjedhjen e bankave agjente në listën paraprake  
për periudhën 2021-2023**

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 39 pika 5 dhe të nenit 42 pika 7 të ligjit nr.53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 22, pika 1, shkronja “a”, të nenit 23, pika 1, të nenit 24, pika 4 dhe pika 5, si dhe të nenit 25 të Rregullores “Për kompensimin e depozitave të siguruara”, të miratuar me Urdhër të Guvernatorit nr. 3762, datë 18.7.2016, të nenit 7, pika 6 të Statutit të Agjencisë, miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 10, pika 6 të Rregullores të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, pas shqyrtimit të raportit të Komisionit të Përhershëm të Vlerësimit për përzgjedhjen e bankave agjente, i ngritur me Vendim të Këshillit Drejtues të Agjencisë nr. 6, datë 30.03.2017, të ndryshuar, Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave

---

**V E N D O S I:**

1. Përzgjedhjen e bankave anëtare të skemës së sigurimit të depozitave në listën paraprake të bankave agjente, për periudhën 2021 – 2023, si vijon:
  - Banka Kombëtare Tregtare SHA renditet në vend të parë.
  - Banka Credins SHA renditet në vend të dytë.
  - Banka Intesa Sanpaolo SHA renditet në vend të tretë.
2. Autorizohet Drejtori i Përgjithshëm për njoftimin e bankave të përzgjedhura fituese dhe për negocimin dhe nënshkrimin me to të kontratës tip për kryerjen e shërbimit të bankës agjente për kompensimin e depozitave të siguruara.
3. Komisioni i Përhershëm i Vlerësimit për përzgjedhjen e bankave agjente ngarkohet për kryerjen e rivlerësimit vjetor të përputhshmërisë së bankave të përzgjedhura në listën paraprake me kriteret e përgjithshme dhe teknike.



## KËSHILLI DREJTUES

4. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm të njoftojë Autoritetin Mbikëqyrës lidhur me këtë vendim.
5. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi  
**Sekretar**

Donald Duraj  
**Kryetar**